



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 84 Prot.

Tiranë, më 11.02.2025

V E N D I M

Nr. 35, Datë 11.02.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 194, datë 18.09.2024, e z. M. S., kundër Kompanisë Shpresa-Al” sh.p.k që ofron shërbimin në linjën e transportit urban Paskuqan-Qendër-Paskuqan, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit nga subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Unë M. Sh., jam student në vitin e III-të në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Degën e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës. Unë jetoj në Paskuqan dhe shkolla ndodhet në Rr. “E Elbasanit” dhe për këtë arsye më duhet të hiqi në autobusin e linjës Paskuqan-Qendër-Paskuqan. Në datën 16.09.2024 hipa në linjën Paskuqan-Qendër-Paskuqan për t’u kthyer në shtëpi pas provimeve që kisha për të dhënë. Sapo hipa në autobus i tregova librezën e verbërisë faktorinos dhe ai më tha “nuk e pranojmë” dhe “zbrit poshtë”. Unë i tregova që unë këtë librezë e përdor çdo ditë dhe të gjithë të tjerët ma kanë pranuar ndërsa vetëm kjo linjë nuk e pranon. Autobusi kishte targën AA682RC. Ai më tha ose paguaj ose zbrit poshtë në tokë. U detyrova të paguaj sepse doja të shkoja në shtëpi.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Shoqërisë së Transportit “Shpresa-AL” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe njohjen e librezës së verbërisë.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Me shkresën nr. 1286/3 prot., datë 24.09.2024 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ankuesi të depozitojë informacion të mëtejshëm në lidhje me çështjen, informacion, i cili u vu në dispozicion nga z. M. Sh., dhe u administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 1286/4 prot., datë 30.09.2024

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1286/5 prot., datë 02.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k. dhe Bashkia Tiranë, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e z. M. Sh., si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

Nga ana e Shoqërisë së transportit “Shpresa-AL” sh.p.k:

- Informacion lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k, ofrohet transporti për personat me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në legjislacionin specifik.
- Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Shoqërisë për sqarimin e zgjidhjen e kësaj problematike.

Nga ana e Bashkisë Tiranë:

- Kopje të kontratës së shërbimit mes Bashkisë Tiranë dhe Shoqërisë së transportit “Shpresa-Al” sh.p.k që ushtron aktivitetin në linjën Paskuqan-Qendër-Paskuqan.
 - Kopje të plotë të licencës të lëshuar nga Bashkia Tiranë për mjetet e Shoqërisë “Shpresa-Al” sh.p.k.
 - Informacion cilat janë masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga ankuesi? Parashtrimet tuaja dhe aktet shkresore provuese, nëse ka.
2. Me shkresën nr. 23 prot., datë 16.10.2024, Shoqëria “Shpresa-Al”sh.p.k ¹, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj përsa i takon pretendimeve të paraqitura nga subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se: *“Në datën 09.10.2024, jemi njohur me shkresën tuaj nr.1286, datë 02.10.2024, lidhur me ankesën që z. M. Sh., ka paraqitur pranë institucionit tuaj. Në lidhje me çështjen që keni parashtruar, shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., ju bën me dije se njeh dhe pranon Librezat e invaliditetit të lëshuara nga institucionet shtetërore përkatëse, të cilat shoqërohen me vërtetimin e KMCAP-it rajonal. Kjo mundëson lehtësira financiare dhe mundësinë e lëvizjes pa pagesë në linjat ku shoqëria jonë ofron transportin e saj.*
- Për çështjen konkrete, kemi kryer hulumtimet tona me stafin e shërbimit të transportit urban. Ata nuk kanë raportuar asnjë rast diskriminimi.*
- Po ashtu, ju informojmë se stafi drejtues i aktivitetit të transportit urban është i udhëzuar që gjatë ushtrimit të punës së tyre të jenë të kujdesshëm dhe mbështetës, veçanërisht ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Kur paraqitet dhe verifikohet librezat e invaliditetit të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe vërtetimi origjinal i KMCAP-it nga personi, punonjësit tanë janë të udhëzuar që të mos kërkojnë biletë dhe të ofrojnë transport falas për personat me aftësi të kufizuara.*
- Gjithashtu, në të gjitha ambjentet e brendshme të autobusëve tanë është afishuar një numër telefoni, ku pasagjerët mund të dërgojnë ankesat apo problematikat e tyre përmes SMS, dhe të marrin përgjigje apo zgjidhje nga stafi mbikëqyrës dhe drejtuesi i tyre brenda një kohe të shkurtër. I sugjerojmë çdo pasagjeri që mund të ketë një problem në lidhje me shërbimin brenda autobusit, ta përdorë këtë numër.*
- Përsa i përket personave të kategorive të veçanta, ata duhet gjithmonë të kenë me vete, kur udhëtojnë me urban, librezën e invaliditetit të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse dhe vërtetimin origjinal të KMCAP-it, dhe ta paraqesin atë pa kontestime kontrolluesve. Shpresojmë që edhe rasti i z. M. Sh., të ketë qenë i njëjtë. I sigurojmë z. Sh. që, me disponimin e një librezë të vlefshme të invaliditetit dhe vërtetimit origjinal të KMCAP-it, ai mund të udhëtojë pa shqetësime dhe pa kosto në linjat ku ofrojmë shërbime, duke e konsideruar problemin e tij të zgjidhur.*
3. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, me shkresën nr. 1286/7 prot., datë 24.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr.1286/6 prot., datë 22.10.2024.

Diskriminimi i përcolli subjektit ankues, parashtrimet e paraqitura nga ana e Shoqërisë “SHPRESA-AL” sh.p.k, për të bërë kundërshtimet e veta.

4. Në përgjigje të shkresës, z. M. Sh dërgoi kundërshtimet e tij², duke informuar se: *Ju informoj se pretendimet e Shoqërisë "Shpresa-AL" janë totalisht të pavërteta. Kjo shoqëri pohon se për rastin në fjalë nuk ka pasur rast diskriminimi, madje cilëson se problematika nuk ka ndodhur asnjëherë, ndërkohë që faktet dhe provat vërtetojnë të kundërtën. Ju informoj se kjo ngjarje jo vetëm që ka ndodhur, por për këtë kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin përkatës, ku përfshihet bileta e autobusit. Për më tepër, ngjarja ka vijuar edhe më tej, pasi është bërë edhe denoncimi pranë Komisarariatit Nr. 5, Kamëz. Pretendimet e Shoqërisë "Shpresa-AL", ku shprehet se punonjësit e kësaj shoqërie janë të udhëzuar që gjatë ushtrimit të detyrës të jenë të kujdesshëm dhe mbështetës, sidomos ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, si dhe të mos kërkojnë biletë, nuk përputhen me realitetin dhe përditshmërinë e kësaj shoqërie dhe të autobusëve të saj. Punonjësit e kësaj shoqërie jo vetëm që janë të papërgatitur dhe negativë në raport me personat me aftësi të kufizuara, por kërkojnë me çdo kusht prerjen e biletës, duke mos njohur librezat e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu personat me verbëri. Shpjegoj se është detyrë e Shoqërisë "Shpresa-AL" jo vetëm që të udhëzojë punonjësit e saj lidhur me rastet si në fjalë, por edhe të marrë masa konkrete për zbatimin e këtyre udhëzimeve. Në rast moszbatimi, kjo shoqëri duhet të marrë masa disiplinore ndaj punonjësve të saj, por duket se ajo nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim dhe vazhdon të mbron interesat e punonjësve të saj. Për sa më sipër, arrij në përfundimin se Shoqëria "Shpresa-Al" ka kryer diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj meje, shtetasit M. Sh., për shkak të aftësive të kufizuara, dhe kërkoj që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të marrë një vendim për konstatimin e diskriminimit.*
5. Me shkresën nr.8886/2 prot., datë 24.10.2024³ Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë, i ka kthyer përgjigje Komisionerit dhe ka informuar se: *Inderuar z. Gajda, Në zbatim të Ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", i ndryshuar, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, është një institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe kryen detyrat funksionale brenda fushës së saj të kompetencave, referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 13, datë 15.01.2010, për "Vendosjen e gjobave në vend ndaj subjekteve për shkeljet e kryera në fushën e transportit rrugor", në cilësinë e strukturës konstatuese dhe dënuese të kundërvajtjeve administrative, ndaj të gjithë operatorëve që ushtrojnë veprimtarinë e transportit publik qytetas në territorin e Bashkisë Tiranë. Në mbështetje të plotë të Ligjit Nr. 119/2014 "Për Të Drejtën e Informimit", referuar shkresës suaj "Njoftim dhe kërkesë për informacion" me nr. 1286/5 prot., datë 02.10.2024, dërguar nga Bashkia Tiranë me nr. 37937 prot., datë 04.10.2024, për t'u*

² Protokolluar pranë Komisionerit me Nr.1286/9 prot., datë 04.11.2024

³ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr.1286/8 prot., datë 28.10.2024

trajtuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe protokolluar me nr. 8886 prot., datë 09.10.2024, ju njoftojmë se, në momentin që u vendosëm në dijeni për shqetësimin tuaj, nga ana jonë u veprua si më poshtë:

Pasi komunikuam me Shoqërinë “Shpresa-AL” sh.p.k., kërkuam zbardhjen e plotë të rastit dhe marrjen e masave, nëse ishim në kushtet e shkëljes së të drejtave të njeriut. Nga ana e tyre, u dërgua shkresa “Informacion mbi ankesën e z. M. Sh.” me nr. 22 prot., datë 18.10.2024, e cila është protokolluar pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit me nr. 9359 prot., datë 18.10.2024. Gjithashtu, i jemi drejtuar Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor me shkresën “Kërkesë për dërgim informacioni” me nr. 8886/l prot., datë 21.10.2024, për t’ju vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga ana juaj në lidhje me kopjen e Licensës së Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k., si dhe, duke qenë se marrëdhënia e tyre është kontraktuale, kopjen e Kontratës së Shërbimit të lidhur mes Bashkisë Tiranë dhe Shoqërisë së Transportit. Bashkëngjitur, do të gjeni kopje të shkresës së Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k. me nr. 22 prot., datë 18.10.2024 dhe të shkresës drejtuar Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor me nr. 8886/l prot., datë 21.10.2024.

6. Me shkresën nr. 41260/1 prot., date 20.11.2024 Drejtoria e Transportit e Trafikut Tiranë, Bashkia Tiranë, ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e kërkuar si mëposht:
- Kopjen e kontratës tip të shërbimit për transportin e udhëtarëve në linjë të rregullt qytetëse.
 - Licencën dhe certifikatat e mjeteve për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.

Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankuesit, caktoi datën 12.12.2024, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1286/11 prot., datë 02.12.2024.

Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., me email e datës 06.12.2024, njoftoi Komisionerin se për arsye të angazhimeve në muajin dhjetor nuk mund të jetë present në këtë datë.

Komisioneri, pasi vlerësoi dhe njëherë kërkesën e Shoqërisë “Shpresa-AL”, caktoi datën 13.01.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1286/12 prot., datë 24.12.2024.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjekti ankues z. M. Sh., si dhe pala kundër të cilit është bërë ankesa, përfaqësuar nga z. D. M., sipas Autorizimit të datës 08.01.2025 të Administratorit të shoqërisë z. L. O.

⁴ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrimeve që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe përmes e-mail-it me KMD-në. U caktuan detyra për të dërguar informacion shtesë në lidhje me pretendimet e secilës palë.

Pas seancës dëgjimore, nga ana e ankuesit, me e-mail të datës 14.01.2024, u vu në dispozicion komunikimi që ishte bërë nga ana e ankuesit në Messenger e faqes zyrtare të Facebook-ut të kompanisë, në të cilin rezultonte se ankuesi e kishte adresuar këtë ngjarje dhe kishte kërkuar një grup kontrolli. Nga ana e shoqërisë ishte marrë një përgjigje aprovuese.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm të ankuesve nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Në ankesën e depozituar nga ana e ankuesit, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të verbër, nga ana Shoqërisë së Transportit “Shpresa-AL” sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës për të udhëtuar falas në linjën e transportit qytetas Paskuqan-Qendër-Paskuqan, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i*

dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankesues.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohe diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁵, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban ndërqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara/të verbër, me biletë me gjysëm çmimi.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi⁶ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas⁷ dhe (3) transport ndërqytetas⁸. Transporti qytetas që përbën objektin e kësaj ankese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbrit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

⁵ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

⁶ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

⁷ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

⁸ Transporti ndërqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar falas ose me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)⁹ parashikon se:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

.....
10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër behet me 0% te tarifave për transportin urban dhe 50% te tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i te verbërit të grupit të parë”.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi¹⁰ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas dhe (3) transport ndërqytetas.

⁹ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

¹⁰ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Transporti qytetas rregullohet nga ana e Bashkisë për veprimtarinë e transportit brenda juridiksionit të saj. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin vendor.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas dhe 50% për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizë Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit””. Aktualisht, ky nen parashikon: “Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit 8098/1996 “Për Statusin e të Verbërit” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban¹¹ falas dhe transport interurban¹²/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së¹³ lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

Referuar nenit 22 të Kontratës së Shërbimit të lidhur mes Bashkisë Tiranë dhe Shoqërisë së Transportit “Shpresa-AL” sh.p.k, është parashikuar se: **Transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve; 1. Operatori i Linjës, me nënshkrimin e kësaj kontrate, merr përsipër respektimin e kuadrit ligjor dhe të akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, lidhur me transportin e kategorive të veçanta të udhëtarëve, si: a. Studentët dhe nxënësit; b. Udhëtimi falas për kategoritë**

¹¹ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹² Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹³ Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

e mëposhtme që zotërojnë librezën përkatëse të lëshuar nga organet kompetente: i. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre; ii. Veteranët e luftës; iii. Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre; iv. Invalidët e punës; v. Personat me aftësi të kufizuara; vi. Jetimët deri në 25 vjeç. 2. Për kategoritë e përcaktuara në paragrafi 1, Operatori i Linjës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në linjat përkatëse falas ose me tarifë të reduktuar, pa kërkuar kompensim operativ nga Bashkia. 3. Bashkia angazhohet, në bashkëpunim me Operatorin e Linjës, të propozojë dhe ndjekë pranë autoriteteve përkatëse hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, lidhur me kompensimin dhe mbulimin e diferencës së çmimit të shërbimit për kategoritë sociale, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, e përfitojnë udhëtimin me çmim të reduktuar dhe/ose falas. 4. Me miratimin e akteve ligjore/nënligjore që do të rregullojnë mënyrën e aplikimit të kompensimit social në fushën e transportit publik qytetas, kategoritë e udhëtarëve që e përfitojnë atë, si dhe masa e përfitimit të tyre, do të fillojë zbatimi i këtij kompensimi social në zbatim të këtyre akteve.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, bazuar në kushtet e Kontratës së Shërbimit të lidhur mes Bashkisë Tiranë, licencës dhe certifikatës tip të automjeteve të shërbimit të transportit të qytetarëve, në dispozitat e përgjithshme të tyre, ka përgjegjësi për sigurimin e lehtësirave për transportin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi dhe atyre të verbër në veçanti. Për më tepër, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k deklaron se njeh dhe zbaton detyrimin e saj, të përcaktuar në aktet ligjore që lidhen me krijimin e lehtësirave për kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara dhe të personave të verbër në veçanti.

Nga informacioni i administruar, subjekti ankues ka pretenduar se, në momentin që i ka paraqitur shoferit të autobuzit me targë AA682RC të Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k, Librezën e Verbërisë,¹⁴ ai nuk e ka njohur dhe i ka kërkuar që të paguajë biletën e plotë të transportit.

Në lidhje me këtë fakt, ankuesi ka vënë në dispozicion biletën me nr. 0914872, Seria 34/24, të cilën e ka paguar pasi shoferi i autobuzit me targë AA682RC ka tentuar ta zbresë nga autobuzi. Për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesi është detyruar të paguajë, pasi kishte vështirësi të kthehej në shtëpi.

Gjithashtu, ankuesi, përmes e-mail-it të datës 14.01.2024, ka vënë në dispozicion të Komisionerit komunikimin e datës 16.09.2024 (*data e pretenduar e diskriminimit*), i bërë përmes Messenger-it në faqen zyrtare të Facebook-ut të kompanisë. Ky komunikim përfshinte një thirrje telefonike dhe një mesazh të shkruar ku ankuesi kërkonte urgjentisht një grup kontrolli për të verifikuar ngjarjen si dhe debatin që po ndodhte me shoferin e autobusit. Nga ana e shoqërisë ishte marrë një përgjigje aprovuese.

¹⁴ Librezës së Verbërisë: nr. 00837, të z. M. Sh, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Nga ana tjetër, edhe pse shoqëria pretendon se ka kamera të vendosura në mjetet e transportit të udhëtarëve në këtë linjë, ajo ka mbështetur këto pretendime vetëm në deklarata verbale dhe argumente pa prova konkrete, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetonte se rasti nuk ka ndodhur, as faktin se si zbatohen rregullat për këtë kategori personash.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban ndërqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, *“Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”*, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë.

Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me Kartat standarde të personalizuar. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar falas në transportin urban qytetas dhe me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar)¹⁵ parashikon se:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

¹⁵ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10/302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*).

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin ligjor specifik.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër bëhet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbërit të grupit të parë”.

Komisioneri, vëren se Shoqëria njeh dhe zbaton detyrimin e saj, përcaktuar edhe në aktet e tjera rregullatore që lidhen specifikisht me të drejtën e ushtrimit të shërbimeve që ofron kjo Shoqëri, sipas Kontratës së Shërbimit të lidhur me Bashkinë Tiranë si dhe Licencën për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetas dhe rrethqytetase të transportit të udhëtarëve, detyrim ky i konfirmuar në përgjigjen zyrtare depozituar pranë KMD-së.

Nga informacioni i administruar, rezulton se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., pas analizimit të rastit, nuk e konfirmon këtë rast që ka ndodhur. Ndërkohë, pala ankuese pretendon se ka paguar vlerën e plotë të këtij shërbimi, edhe pse nga ana e tij është treguar librezë e verbërisë e lëshuar nga SHSSH. Shoqëria ka bërë të ditur se, për të gjithë individët që paraqesin librezën e të verbërit, respektohen parashikimet e ligjit për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, duke pranuar udhëtimin falas pa biletë, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Ndërkohë referuar fakteve dhe provat të mbledhura gjatë shqyrtimit administrativ të rastit, përfshirë paraqitjen e librezës të verbërisë nga ankuesi, reagimit të shoferit të autobuzit, pagesës së detyruar të biletës, si dhe komunikimit të datës 16.09.2024 (*data e pretenduar e diskriminimit*), i bërë përmes Messenger-it në faqen zyrtare të Facebook-ut të kompanisë, ky në këtë komunikim po atë ditë përfshinte një thirrje telefonike dhe një mesazh i shkruar ku ankuesi kërkonte urgjentisht një grup kontrolli për të verifikuar ngjarjen dhe debatin që po ndodhte me shoferin e autobusit, përgjigjes aprovuese të shoqërisë që u vu në dijeni të ngjarjes, krijojnë bindjen e prezumimit të diskriminimit dhe cënimit të të drejtave të ankuesit.

Një tjetër fakt që u konstatua gjatë seancës dëgjimore të datës 13.01.2025, ishte se ankuesi kishte komunikime të mëparshme përmes Messenger-it në faqen zyrtare të Facebook-ut të kompanisë, ku kishte ngritur shqetësime të tjera që kishte me këtë linjë transporti, pra nuk ishte rasti i parë që kishte ndodhur, por ishte një rast i përsëritur. Gjithashtu dhe pse referuar fakteve të reja që dolën gjatë seancës dëgjimore u caktuan detyra për të dërguar informacion shtesë në lidhje me

pretendimet e palëve, nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k, nuk u dërgua asnjë informacion i tillë.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i fakteve të paraqitura dhe dokumentacionit të administruar, vërehet se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, edhe pse ka pasur mundësinë të paraqesë prova dhe fakte për të kundërshtuar informacionet dhe provat e ofruara nga ankuesi, nuk ka arritur të ofrojë asnjë dokumentacion që të vërtetonte se ngjarja e pretenduar nuk ka ndodhur. Në kundërshtim me pretendimet e shoqërisë, nuk është paraqitur asnjë provë konkrete që të argumentonte se rregullat dhe detyrimet ligjore për sigurimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuara janë zbatuar siç duhet.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, ka ekspozuar subjektin ankues, i cili bënë pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit qytetas me pa pagese.

B. Shkak i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁶, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe ekzistojnë prova të mjaftueshme/dokumente, që ankuesi e mbarti atë.

¹⁶ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

- Referuar Librezës së Verbërisë: nr. 00837, të z. M. Sh, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me aftësinë e kufizuar.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”. (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta ka parshikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm

në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁷. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet

¹⁷ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁸. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁹. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14²⁰.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”²¹ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesë e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe transporti. Në gërmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ë) në

¹⁸ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁹ Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

²⁰ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

²¹ Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

transport....”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe *transporti*.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: *“Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve*. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se:

“3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në të gjitha shërbimet publike.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, *“Diskriminimi”* përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkreisht, në nenin 20, pika 1, dhe pika 2, shkronjat “a” dhe “ë”, të LMD parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime*

në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku;”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²² gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Një qasje e ngjashme gjendet në kuadrin e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale të Këshillit të Evropës (*organi mbikëqyrës i Kartës Sociale Evropiane*), i cili gjithashtu u shpreh se ligji vendas, kombëtar duhet të sigurojë një lehtësim të barrës së provës në favor të paditësit në rastet e diskriminimit. Në të vërtetë, siç thuhet në Përmbledhjen e praktikës gjyqësore të Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale dhe gjithashtu thuhet nga GJEDNJ në çështjen në fjalë, barra e provës nuk duhet të jetë tërësisht mbi palën kërkuese dhe duhet të jetë objekt i një rregullimin e duhur në rast të diskriminimit.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.²³

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, subjekti ankues, nuk kanë përfitur nga transporti urban në linjën e ofruar nga operatori “Shpresa-AL” sh.p.k, për arsyet e cituara më sipër.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, kundrejt subjektit ankues, si person me aftësi të kufizuar, të

²² Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

verbër dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, duhet të përmbushë dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi, lidhur me lehtësimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesit, që është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që veprimet dhe mosveprimet e saj kundrejt ankuesit, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., nuk ka vepruar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Komisioneri vëren se, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., ka dështuar në marrjen e masave për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.

Pavarësisht mundësive të ofruara për të kundërshtuar informacionet dhe faktet e administruara nga ankuesi, shoqëria nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të besueshëm që të vërtetonte se ngjarja nuk ka ndodhur dhe se ka zbatuar rregullat ligjore për udhëtimin e personave me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjektit ankues i është mohuar një e drejtë, e cila i është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesin, për sa i takon ofrimit të transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe në detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kushteve të kontratës së shërbimit dhe licencës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion dhe dokumentacion në lidhje me masat konkrete, për njohjen e Librezës së Verbërisë dhe të udhëtimit pa pagesë në transportin qytetas, për kategorinë e personave të verbër. Shoqëria ka mbështetur çdo pretendim vetëm në deklaratë verbale dhe argumente të dhëna pa prova konkrete, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton se si zbatohen rregullat për këtë kategori të personave.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Shoqëria “Shresa-AL” sh.p.k., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuara, në zbatim të detyrimeve ligjore që asaj i burojnë drejtëpërdrejtë nga ligji dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla.

Komisioneri thekson se, në praktikën e tij, ka konstatuar shkelje të ndalimit të diskriminimit të parashikuar nga LMD, të ndryshuar, në çështje të ngjashme (Vendimet: nr. 93, datë 09.06.2023, nr. 175, datë 11.09.2023 dhe nr. 182, datë 10.06.2024), ku shoqëri transporti të ndryshme, nuk kanë marrë masa për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar subjekti ankues. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i z. M. Sh., përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar²⁴ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t’u justifikuar²⁵.”

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të LMD, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/15, nuk ka përcaktuar se: “Si mjet të fundit, veçanërisht kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, komisioneri mund t’u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij”.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet

²⁴ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

²⁵ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj subjektit ankues z. M. Sh., pasi rezultoi se Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k., nuk ka marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tij, lidhur me udhëtimin me pa pagese në transportin qytetas.

Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e udhëtimit pa pagese në transportin qytetas, për personat me aftësi të kufizuar, të verbër, bazuar në legjislacionin në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të z. M. Sh., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria “Shpresa-AL” sh.p.k, të trajtojë me seriozitet të plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ankesat që i adresohen për çdo cenim të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar gjatë ofrimit të shërbimit të transportit. Shoqëria duhet të angazhohet për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo ankese, duke respektuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe duke siguruar një proces të qartë, transparent dhe të përgjegjshëm.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Shoqëria “Shresa-Al” sh.p.k., të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA